

Analizë e Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2018

HULUMTIM PARLAMENTAR

01/2019



Analizë e Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2018

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillimi i qëndrueshëm**

Publikimi: **Qershor, 2019**

Foto e ballinës: **Unsplash**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting Freedom Around the World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Analiza e Raportit.....	2
Përshkrimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji	2
Aktivitetet e Zyrës së Rregullatorit për Energji	4
Bashkëpunimi me palët tjera dhe transparenca	8
Raportimi financiar për Rregullatorin	8
Sektori i Energjisë Elektrike	9
Përfundime dhe Rekomandime	10
Shtojcë - Pyetjet pa përgjigje në Raportin Vjetor të ZRRE-së për vitin 2018.....	11

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), si pjesë e programit për Qeverisje Demokratike, dhe projektit për rritje të llogaridhënjes ka analizuar Raportin Vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin 2018. Analiza e INDEP është e fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e kualitetit të raportimit, të gjendjes së sektorit të energjisë në Kosovë si dhe në hartimin e rekomandimeve për Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Raportimi në Kuvend i ZRRE-së është instrumenti kryesor i Kuvendit për mbikëqyrje parlamentare dhe kërkim të llogaridhënjes. Përmes tij, Kuvendi ka mundësinë që të informohet mbi fushën e energjisë në vend dhe për punën e Rregullatorit në adresimin e sfidave paraprake dhe sfidave të reja. Kuvendi, duke ushtruar funksionin mbikëqyrës, ka shansin që përmes diskutimit mbi këtë raport të krijoj memorie institucionale mbi gjendjen e sektorit dhe të shfrytëzoj atë në procese legjislative brenda fushëveprimit të tij. Për këtë, raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji është moment i rëndësishëm në punën e Kuvendit dhe organizatave që monitorojnë punën e Kuvendit.

Raporti Vjetor i ZRRE-së nuk i shërben vetëm realizimit të llogaridhënjes para deputetëve në lidhje me punën e Rregullatorit. Përkundrazi, raporti ka për qëllim edhe informimin e qytetarëve, investitorëve potencial, komunitetit akademik etj. Për këtë, gjuha e përdorur dhe kualiteti i raportimit në raportet e ZRRE-së, dhe të agjencive të pavarura në përgjithësi ka rëndësi të madhe për realizimin e llogaridhënjes, transparencës. Të gjitha këto, kontribuojnë që raporti të shërbej si referencë për punën e ZRRE-së dhe gjendjen e sektorit të energjisë në vend.

Analiza e INDEP është organizuar në atë mënyrë që të pasqyrojë strukturën e raportit të ZRRE. Pas Hyrjes dhe Përmbledhjes Ekzekutive, është analizuar çdo pjesë e raportit të ZRRE-së. Ne kemi trajtuar kryesisht kualitetin e raportimit me qëllim që të informojmë deputetët mbi pjesët ku ka nevojë për informata shtesë apo sqarime shtesë. Në analizën tonë janë përshkruar edhe [pyetje](#) të cilat nuk kanë përgjigje brenda raportit dhe për të cilat ne kemi vlerësuar se duhen sqaruar.

Kjo analizë është hartuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Të gjeturat, qëndrimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NED.

Analiza e Raportit

Përshkrimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Në pjesën e përshkrimit të Zyrës së Rregullatorit, ZRRE ka dhënë informata të përgjithshme mbi mandatin ligjor që e ka dhe strukturën e saj. Është përshkruar bordi dhe janë dhënë emrat e anëtarëve të bordit por nuk është dhënë koha e skadimit të mandatit të tyre. Rregullatorët pa anëtar bordi kanë paraqitur problem të madh në të kaluarën dhe ne konsiderojmë që informimi i deputetëve mbi kohën kur i skadon mandati secilit anëtar të bordit është shumë i rëndësishëm.

Pra, është me rëndësi të informohen deputetët se [kur u skadon mandati anëtarëve aktual të Bordit të ZRRE-së?](#)

Raporti vjetor duhet të shërbej edhe për të paraqitur një pasqyrë mbi burimet njerëzore të ZRRE-së. Në tabelën 2.1 tek Struktura Organizative ndarja e të punësuarve nuk është bërë për secilën pozitë por vetëm për departamente. Po ashtu, mungon një ndarje e pozitive në bazë të strukturës gjinore, moshës, përgatitjes profesionale dhe trajnimeve të ndjekura. Pra nuk dihet: [Cila është struktura gjinore, e moshës, përgatitjes profesionale dhe përgatitjes në punë e punonjësve të ZRRE-së?](#)

Në raport thuhet se: Personeli i Rregullatorit është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësive që ata mbulojnë. Ky kombinim eksperiencash inxhinierike, ekonomike, juridike dhe të tjera e përforcon besimin për një institucion me strategji të qartë drejt suksesit në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë.¹ Megjithatë, nuk ka ndonjë shpjegim mbi nevojën ose jo për pozita të reja dhe për përgatitje profesionale. Nuk dihet [a ka nevojë për staf të ri Rregullatori dhe në cilat pozita ka nevojë më shumë të plotësohen.](#) Projektet e asistencës teknike janë përmendur por nuk janë vënë në një kornizë krahasuese me vitet e tjera ose në kornizë krahasuese me kapacitetet aktuale njerëzore të ZRRE-së. Për këtë, është e rëndësishme

Në përfundim të raportit ZRRE thekson:

ZRRE është i mendimit që pagat e anëtarëve të stafit duhet të jenë të pajtueshme me nivelet e pagave të industrisë së rregulluar, me qëllim që të shmanget “rrjedhja e trurit” drejt industrisë dhe t’i mundësojnë ZRRE-së të tërheqë dhe mbajë burime njerëzore të kualifikuara dhe të mjaftueshme për të zbatuar përgjegjësitë e saj, andaj përfshirja e ZRRE në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik rrezikon fuqishëm largimin e personelit të ZRRE të aftësuar dhe kualifikuar të cilët mund të gjejnë pozita më të mirë-paguara dhe më të sigurta jashtë ZRRE-së.²

Megjithatë, në pjesën e burimeve njerëzore nuk sqarohet se [sa punonjës të ZRRE-së e kanë lëshuar punën dhe janë larguar gjatë vitit 2018 apo sa rrezikohet të humben gjatë 2019, cila është përgatitja e tyre profesionale dhe në cilat fusha ZRRE e ka të vështirë t’i zëvendësoj ata që janë larguar për arsye të pagave të ulta?](#)

Aktivitetet e prokurimit

Në raport, në pjesën e aktiviteteve të prokurimit, thuhet:

Rregullatori është duke u përballur me shumë probleme si pasojë e mosrealizimit të procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Si pasojë e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik, operimi i zyrës është vështirësuar nga procedurat e stërzgjatura të ndjekura nga AQP, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të

¹ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2018, faqe 13, Prishtinë: ZRRE.

² Ibid, faqe 133.

prokurimit. Kjo ka bërë që zyra akoma të mbetet pa shërbime dhe furnizime të cilat janë të domosdoshme për një funksionim normal të saj.³

ZRRE duhet të sqaroj nëse vonesat në procedura të prokurimit kanë ndikuar në kryerjen e misionit të ZRRE-së. [Për cilat shërbime dhe furnizime bëhet fjalë dhe çfarë ka ndikuar specifikisht në punën e ZRRE-së?](#)

Aktivitetet e Zyrës së Rregullatorit për Energji

Në pjesën e aktivitetëve të ZRRE-së, mungojnë disa informata që do të ishin të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të thjeshtuar të legjislacionit. Licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë, me theks të veçantë në fushën e burimeve të ripërtrishme, nuk është një proces i thjeshtë. Një proces në formë grafikoni do të duhej të shpjegohej në mënyrë që të ishte e qartë se nëpër çfarë procedurash duhen kaluar investitorët për të realizuar investimin në fushën e energjisë së ripërtrishme. Në raport thuhet se “janë të përfshirë shumë institucione tjera në Kosovë”, por nuk përmenden cilat si dhe hapat që një investitor duhet të ndjekë.

Në raport thuhet se ndërmarrja “Kelkos” është duke kryer operim komercial pa Leje Mjedisore.

Pavarësisht kësaj Kelkos ka vazhduar me operimin e HC Deçani dhe HC Belaje, pa licencë. Fillimisht ky aktivitet është kryer si operim testues, por nga 01 prill 2016 gjeneratorët janë në operim komercial. Rregullatori ka udhëzuar ndërmarrjen që të sjell Lejen Mjedisore për këto hidrocentrale, në mënyrë që të mund të lëshoj licencën për operim. Ende nuk ka progres në këtë drejtim, prandaj dhe “KelKos Energy” SH.P.K. nuk posedon ende licencë për prodhim të energjisë elektrike.⁴

ZRRE duhet të sqaroj se [cilat masa janë ndërmarrë që të mos ketë operim komercial pa licencë?](#) Nëse një kompani nuk ka marrë Leje Mjedisore kjo do të thotë që projekti nuk është në përputhje me standardet mjedisore dhe rrezikon ndotjen apo degradimin e mjedisit. Për këtë, ZRRE duhet të sqaroj se për çfarë bëhet fjalë dhe përse operimi nuk është ndaluar.

Në pjesën e licencimit të aktivitetëve të furnizimit, në raport thuhet: përveç KESCO-s, ndërmarrjet tjera të licencuara për aktivitet të furnizimit me energji elektrike në Kosovë deri më tani ende nuk kanë kryer aktivitet të furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike.⁵ Në procesin e liberalizimit të tregut, operimi i furnizuesve të energjisë elektrike është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ky element, plotëson të drejtën e konsumatorëve për ndërrim të furnitorëve, e përcaktuar me nenin 36 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Kjo pjesë e raportit duhet të sqarojë se [cilat janë arsyet për të cilat furnitorët nuk po ofrojnë shërbime në treg dhe se çfarë ka bërë Rregullatori gjatë vitit 2018 për të përmbushur këtë të drejtë të konsumatorëve?](#)

Në faqen 19 të raportit, shpjegohen kohëzgjatjet e dhënjes së licencave, me ç’rast thuhet:

³ Ibid, faqe 15.

⁴ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2018, faqe 18, Prishtinë: ZRRE.

⁵ Ibid, faqe 19.

Siç mund të shihet edhe nga tabela e më sipërme ndërmarrjet "FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS" SH.P.K., "Jaha Company "SH.P.K, dhe "SharrCem" SH.P.K, janë licencuar për periudhën pesë (5) vjeçare ndërsa "Korporata Energjetike e Kosovës" SH.A për periudhën njëzetepesë (25) vjeçare, në pajtim me nenin 32 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, sipas të cilit përcaktohet kohëzgjatja e licencës së furnizimit varësisht nga gjendja financiare e aplikantit me kohëzgjatje maksimale prej njëzet e pesë (25) vjetësh.⁶

Dhënja e licencës për njëzet e pesë vite për Korporatën Energjetike të Kosovës nuk është një vendim dosido. ZRRE duhet të sqaroj se çfarë ka marrë parasysh me togfjalëshin në ligj "varësisht nga gjendja financiare" dhe a ka faktorë të tjerë që kanë ndikuar në vendim? Si kanë qenë financiarisht aplikantët tjerë në krahasim me KEK?

ZRRE në faqe 20 të raportit ka deklaruar se "nuk ka pranuar asnjë aplikim të ri për licencim të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike. Arsye për këtë mund të jenë dispozitat 2 dhe 3 e nenit 32 të ligjit për energji elektrike..."⁷ Këtu ZRRE citon këto dispozita dhe nuk sqaron se çfarë ndërlidhje kanë këto dispozita konkretisht, sipas ZRRE-së me mungesën e aplikacioneve? A janë këto dispozita pengesë dhe si konsideron ZRRE se ato do të mund të ndryshoheshin?

Në pjesën e **monitorimit të ndërmarrjeve të energjisë** ekzistojnë dy probleme të mëdha:

1. Raporti i ZRRE-së nuk sjellë asnjë informatë substanciale mbi monitorimin
2. Raporti i referohet një raportit tjetër dhe udhëzon deputetët ta gjejnë atë në faqen elektronike të ZRRE-së.

Në raportin e ZRRE-së vetëm janë sqaruar obligimet e ZRRE-së për monitorim dhe është raportuar se ka ndodhur ky aktivitet. Të dhënat që mungojnë janë:

- Sa monitorime ka pasur gjatë vitit 2018 dhe për çfarë aktivitete?
- Cilat janë të gjeturat e Rregullatorit në numra sa i takon këtyre monitorimeve?
- Përse nuk është shqiptuar asnjë gjobë gjatë vitit 2018? A kanë performuar pa asnjë shkelje operatorët apo shkeljet kanë qenë të natyrave të lehta? Nëse është kjo e dyta, duhet sqaruar për çfarë gjetjesh bëhet fjalë?

Për më tepër, ZRRE në raport deklaron: "Raporti i detajuar mbi monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë gjatë vitit 2018 do të përgatitet nga Rregullatori dhe do të publikohet në faqen elektronike të Rregullatorit."⁸ Monitorimi i akterëve në tregun e energjisë në Kosovë është një nga përgjegjësitë kryesore të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Të dhënat për këtë proces janë jashtëzakonisht të rëndësishme për të parë se sa po e kryen mandatin e vet ZRRE. Nuk mundet që Rregullatori të udhëzojë deputetët dhe lexuesit e raportit që të presin publikimin e një raportit shtesë për monitorimet.

Asnjë e dhënë empirike nuk është ofruar sa i përket aktiviteteve të monitorimit të ndërmarrjeve në tregun energjisë, monitorimit të ndërprerjeve të energjisë elektrike, të furnizimit dhe mbrojtjes së konsumatorëve etj.

⁶ Ibid.

⁷ Ibid, faqe 20.

⁸ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2018, faqe 21, Prishtinë: ZRRE.

Ngjashëm me këtë të njëjtën heshtje me po të njëjten fjali, Raporti e bënë edhe tek:

- Monitorimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike për të cilat prapë sugjeron t'i referohemi një raportit që do të dalë në uebsajt!

Raporti duhet të përmbaj të gjitha të dhënat mbi monitorimin sepse ky proces garanton mbrojtjen e interesit publik dhe ruajtjen e ligjshmërisë. Në formën e tanishme, Raporti i ZRRE-së nuk ofron asnjë të dhënë substanciale dhe asnjë analizë për monitorimin.

Në pjesën e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, prapë mungon një analizë objektive dhe substanciale mbi shkaqet, tregun dhe situatën ligjore dhe praktike. Në pjesën e raportimit mbi autorizimet preliminare, theksohet se ka rritje nga viti i kaluar.




Figura 1. Autorizimet preliminare ndër vite. Burimi: ZRRE

Nga ana tjetër, ka një rënje të autorizimeve finale të leshuara por këtë nuk e përmend raporti.




Figura 2. Autorizimet finale ndër vite. Burimi: ZRRE

Në pjesën e gjeneratorëve për vetë-konsum në faqe 31 dhe 32, Raporti informon mbi dhënjen e 3 licencave dhe më tutje thotë: “Rregullatori, poashtu ka pranuar edhe kërkesa tjera nga personat fizik dhe juridik, të cilat janë në faza të ndryshme të kompletimit dhe sipas procedurave në fuqi, dhe pas kompletimit do të lejohet ndërtimi i këtyre kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum.” Nuk ka një shpjegim se sa kërkesa të tjera janë në pritje për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues me vetkonsum? Cilat janë procedurat për marrjen e këtij statusi dhe sa zgjatë kjo procedurë?

Kjo është shumë e rëndësishme pasi konsumatorët me vetë-konsum kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për uljen e konsumit dhe për ushqimin e rrjetit me energji.

Sa i takon Projektit “Kosova e Re”, Zyra e Rregullatorit për Energji ka raportuar mbi tendencën për vënjen e një Obligimi të Shërbimit Publik dhe ashtu siç ka raportuar INDEP, kjo do të bëhet vetëm për të mbuluar “kthimin e sigurt të investimeve” për një kontratë miliardëshe. Raporti thekson se: “rregullatori ka përgatitur “draft raportin konsultativ për zhvillimin e sigurisë së furnizimit (PSO)” për vendosjen e obligimit të shërbimit publik mbi furnizuesit që furnizojnë konsumatorët në Kosovë që të paguajnë një taksë për NKEC, për të siguruar kthim të sigurt të investimeve të bëra nga investitori sipas marrëveshjes së nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës dhe investitorit.”⁹ Megjithatë, ZRRE nuk sqaron se:

- Cila është kostoja financiare që do ta paguajnë qytetarët e Kosovës nëse kjo PSO miratohet?
- Sa palë kanë komentuar në këtë PSO dhe a mund t'i sjellë ZRRE në Kuvend ato qëndrime?
- Cili ka qenë qëndrimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nëse ka pasur komente) në lidhje me këtë dokument?
- A u është kthyer përgjigje me shkrim dhe a janë marrë parasysh komentet e të gjitha palëve?

⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2018, faqe 34, Prishtinë: ZRRE.

Vendosja e Obligimit të Shërbimit Publik dhe pagesa e taksës për siguri të furnizimit, për INDEP është e paarsyeshme marrë në konsideratë që energjia elektrike është produkt elementar, për siguri të së cilit qytetarët nuk duhet të paguajnë taksë. Më tutje, taksa “për siguri të furnizimit” pikërisht minon sigurinë pasi e bënë energjinë elektrike produkt të papërballueshëm për qytetarët, e dihet se përballueshmëria e çmimeve është ndër kushtet themelore të sigurisë së furnizimit.¹⁰

Në pjesën e shqyrëimit të dytë periodik 2019 – 2022, ZRRE nuk sqaron [ndryshimet kryesore në dokumentet për këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake të shqyrëimit](#). Në formë tabelare duhen paraqitur të gjitha ndryshimet në mënyrë krahasuese në mënyrë që të shihet se çfarë ka ndryshuar dhe cila do të jetë kostoja dhe përfitimi i konsumatorëve nga këto vendime. Gjithashtu, janë listuar 13 dokumente që drejtëpërdrejtë ndikojnë në koston e energjisë që qytetarët e paguajnë. Megjithatë, nuk janë sqaruar fare se cilat janë ndryshimet në këtë periudhë me periudhën paraprake. Për shembull, [nëse në këtë periudhë, mesatarja e ponderuar e kapitalit ka qenë 8.3%, sa ka qenë në të kalurën dhe cila është metodologjia që është përdorur për të sjellë një mesatare të tillë etj?](#) Raporti, edhe në këtë pjesë, nuk sqaron se [cili është numri i komenteve që ka marrë ZRRE dhe sa prej tyre janë marrë parasyshe e sa jo dhe se a u është ofruar përgjigje me shkrim palëve që kanë komentuar?](#)

Bashkëpunimi me palët tjera dhe transparenca

Zyra e Rregullatorit për Energji nuk është e shquar për transparencë dhe bashkëpunim ashtu siç është paraqitur në raport. INDEP gjatë vitit 2018 ka analizuar raporte konsultative dhe dokumente të ZRRE-së dhe ka dërguar komente. Në asnjërin nga këto analiza dhe komente, ne nuk kemi marrë përgjigje me shkrim mbi statusin e tyre, pranimin apo refuzimin e tyre. Në përgjithësi, Rregullatori nuk raporton se [sa vendime gjatë vitit 2018 janë ndryshuar apo modifikuar si rezultat i konsultimeve publike? A ekzistojnë raporte të konsultimit me palët ku sqarohen të gjitha komentet dhe shqyrtohen me objektivitet?](#)

Gjithashtu, faqja elektronike e Rregullatorit është jashtëzakonisht e limituar për përdoruesit. Ka ditë dhe periudha në të cilat nuk funksionon fare dhe seksioni i konsultimeve publike nuk është lehtë i dallueshëm. Në pjesën e dëgjimeve publike në faqe 65 janë listuar dokumentet të cilat ZRRE i ka kaluar përmes dëgjimeve publike. Sërish, asnjë e dhënë mbi numrin e pjesëmarrësve në dëgjime, numrin e komenteve të marra apo rezultateve të arritura nga ato dëgjime, tryeza dhe konsulta.

Raportimi financiar për Rregullatorin

Shpenzimet e Rregullatorit duhet të pasqyrojnë mandatin që ka rregullatori. Në buxhet shihet se buxheti i shpenzuar për medijtë është më shumë se dyfish më i lartë se buxheti për shpenzime të udhëtimit. Për këtë, INDEP konsideron që duhet kërkuar një sqarim nga ana e ZRRE-së se si është e mundshme që shpenzimet e medijtëve të tejkalojnë shpenzimet e udhëtimit dhe se cilat janë politikat e ZRRE-së rreth shpenzimeve të udhëtimit.

¹⁰ Shih Analizën e INDEP dhe BGF: “Vendosja e Obligimit të Shërbimit Publik për Siguri të Furnizimit” https://indep.info/wp-content/uploads/2019/02/Analiza-e-Dokumentit-Konsultativ-te-ZRRE_INDEP_BGF.pdf

Një e dhënë shqetësuese e paraqitur në raport është niveli i realizimit të investimeve kapitale. Vetëm 31,56% e investimeve kapitale janë realizuar gjatë vitit 2018. ZRRE sqaron se arsyeja kryesore për këtë janë procedurat në Agjencinë Qëndrore të Prokurimit. Megjithatë, nuk ka asnjë sqarim se si ka

Vetëm 31,56% e buxhetit për investime kapitale është realizuar në vitin 2018.

ndikuar mosrealizimi i 2/3 të buxhetit për investime në kryerjen e mandatit dhe misionit të ZRRE-së. Cilat investime kanë mbetur të pa realizuara dhe cilat janë pasojat në interesin publik dhe performancën e ZRRE-së?

Sektori i Energjisë Elektrike

Ekziston një diskrepancë në qëndrime të Zyrës së Rregullatorit për Energji në raporte të ndryshme sa i takon adekuacisë së gjenerimit.

Raporti Vjetor i ZRRE-së për vitin 2018 (mars, 2019)	Dokumenti i propozuar për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik për Siguri të Furnizimit (Vendosja e taksës për Siguri të Furnizimit) (shkurt, 2019)
Në pjesën e adekuacisë së gjenerimit në faqe 76, ZRRE thekson: Adekuacia e gjenerimit dhe siguria e furnizimit në sistemin elektroenergetik të Kosovës, janë në nivel të pranueshëm dhe vlen të theksohet se gjenerimi i energjisë elektrike së bashku me importin plotësojnë konsumin nacional të energjisë elektrike.	ZRRE-ja mendon se ekziston një problem i adekuacisë së gjenerimit i cili është duke vazhduar dhe do të vazhdoj deri në vitin 2026.

Pra, ZRRE në raportin vjetor thekson qartësisht se adekuacia në nivelin maksimal i adekuacisë së gjenerimit prej 89.4% është i pranueshëm. E kundërta thuhet në raportin e Vendorsjes së Obligimit të Shërbimit Publik me anë të së cilit, ZRRE po tenton t'u vë taksë qytetarëve të Kosovës në emër të sigurisë së furnizimit. Kjo tregon se ZRRE është nën presion për të imponuar një PSO të paligjshme, të pa arsyeshme dhe të dëmshme për qytetarët.

Në faqe 88 të Raportit, që flet për Reduktimet si Pasojë e Mungesës së Energjisë Elektrike, ZRRE thekson se ZRRE ka marrë masa për ndërprerjen e plotë të reduktimeve mirëpo nuk sqaron se cilat masa janë marrë për të ndaluar reduktimet. A janë ndëshkuar kompanitë përgjegjëse dhe cili ka qenë efekti?

Një tjetër element i raportit janë investimet e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Sistemit të Distribucionit. Një listë investimesh është paraqitur por ajo nuk është aspak e qartë. Investimet duhen raportuar:

- me shifra të parave të investuara për secilin investim;

- me ndërlidhje me Planin Zhvillimor të Operatorit (vjetor dhe afatgjatë)
- me analizë të efekteve në sistem dhe planeve për të ardhmen

Këto të dhëna mungojnë në raportin e ZRRE-së. Përmirësimi i tyre do t'i ndihmonte shumë transparencës informimit më të sakt të publikut i cili në fund të ditës i paguan këto investime me faturë të rrymës.

Përfundime dhe Rekomandime

Raporti Vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2018 është deskriptiv por jo analitik. Një numër i konsiderueshëm i të dhënave mungojnë dhe paraqitja e tyre lë shumë për të dëshiruar. Ky raport, ndonëse si kuantitet ka informata të shumta, një pjesë e rëndësishme e tyre mungojnë dhe sidomos mungon analiza e impakteve, shkaqeve, analiza krahasuese dhe vlerësime mbi ndikimet e investimeve, vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve në sistemin energjetik në vend dhe interesin publik.

Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të kërkoj nga ZRRE që para se të miratohet rekomandimi pozitiv i Komisionit për Raportin, atij ti bashkangjitet një dokument me sqarime për të gjitha pyetjet që aktualisht nuk kanë përgjigje në këtë Raport. Më pastaj, Komisioni të shqyrtoj përgjigjet dhe të votoj për miratimin e raportit të plotësuar.

Një pjesë e aktiviteteve të Rregullatorit nuk janë paraqitur. Është raportuar obligimi për monitorim dhe disa monitorime individuale të projekteve nga ana e ZRRE-së por jo edhe rezultatet e këtyre monitorimeve. Nuk është treguar numri i sakt i monitorimeve, gjetjet, rekomandimet, niveli i zbatimit të tyre, ndonjë masë ndëshkimore apo vërejtje etj. Ka nevojë që raporti të plotësohet me këto të dhëna për të pasur një pasqyrë, jo thjeshtë të obligimeve ligjore që ka ZRRE, por të rezultateve që janë arritur në implementimin e tyre.

Raporti nuk jep detaje mbi nivelin profesional të punonjësve të ZRRE-së sidomos në pjesën e trajnimeve. Përmenden trajnimet por nuk paraqiten statistika se sa punonjës janë të trajnuar, çfarë profilesh gjinore, të moshës dhe profesionale janë të trajnuara, a ekziston një listë e trajnimeve të kryera dhe trajnimeve që ka nevojë të kryej ZRRE etj.

Raporti ka nevojë të plotësohet me të dhëna edhe sa i takon aktiviteteve tjera siç është licencimi i gjeneratorëve me vetkonsum, pastaj paspojat e mosrealizimit të 2/3 të investimeve kapitale, draft dokumenti mbi vendosjen e PSO-së për siguri të furnizimit, me dokumentet e shqyrtimeve tarifore përfshirë WACC, të Hyrat Maksimale të Lejuara etj.

Dokumenti dështon t'u përgjigjet një numri të madh të pyetjeve. Përgjigjet e tyre, duhen dhënë ose në seancë dëgjimore të Komisionit, ose me shkrim. Në të kundërtën, Raporti nuk paraqet pasqyrë të plotë të gjendjes në sektorin e energjisë në vend. Raporti i ZRRE-së, me plotësimet që duhet të bëhen, ka mundësinë t'i shërbej zhvillimit të sektorit, informimit të deputetëve, investitorëve, botës akademike dhe publikut të gjerë.

Shtojcë - Pyetjet pa përgjigje në Raportin Vjetor të ZRRE-së për vitin 2018

1. Kur u skadon mandati anëtarëve aktual të Bordit të ZRRE-së?
2. Cila është struktura gjinore, e moshës, përgatitjes profesionale dhe përgatitjes në punë e punonjësve të ZRRE-së?
3. A ka nevojë për staf të ri Rregullatori dhe në cilat pozita ka nevojë më shumë të plotësohen
4. Meqë në raport përmenden pagat: Sa punonjës të ZRRE-së e kanë lëshuar punën dhe janë larguar gjatë vitit 2018 apo sa rrezikohet të humben gjatë 2019, cila është përgatitja e tyre profesionale dhe në cilat fusha ZRRE e ka të vështirë t'i zëvendësoj ata që janë larguar për arsye të pagave të ulta?
5. Mbi ankesën për procedurat e AQP-së: Për cilat shërbime dhe furnizime bëhet fjalë dhe çfarë ka ndikuar specifikisht në punën e ZRRE-së?
6. Cilat masa janë ndërmarrë që të mos ketë operim komercial pa licencë? – të kompanisë Kelkos e cila siç raporton ZRRE ka operuar komercialisht pa Leje Mjedisore.
7. Cilat janë arsyet për të cilat furnitorët nuk po ofrojnë shërbime në treg dhe se çfarë ka bërë Rregullatori gjatë vitit 2018 për të përmbushur këtë të drejtë të konsumatorëve? – të drejtën për ndërrim të furnitorit.
8. Në lidhje me licencën prej 25 vitesh për KEK - çfarë ka marrë parasysh me togfjalëshin në ligj “varësisht nga gjendja financiare” dhe a ka faktorë të tjerë që kanë ndikuar në vendim? Si kanë qenë financiarisht aplikantët tjerë në krahasim me KEK?
9. Në lidhje me nenin 32 të Ligjit Nr. 05/L-085 Energji Elektrike dhe aplikacioneve për furnizim me shumicë: për çfarë ndërlidhje kanë këto dispozita konkretisht, sipas ZRRE-së me mungesën e aplikacioneve? A janë këto dispozita pengesë dhe si konsideron ZRRE se ato do të mund të ndryshoheshin?
Në lidhje me monitorimin e operatorëve në tregun e energjisë:
10. Sa monitorime ka pasur gjatë vitit 2018 dhe për çfarë aktivitete?
11. Cilat janë të gjeturat e Rregullatorit në numra sa i takon këtyre monitorimeve?
12. Përse nuk është shqiptuar asnjë gjobë gjatë vitit 2018? A kanë performuar pa asnjë shkelje operatorët apo shkeljet kanë qenë të natyrave të lehta? Nëse është kjo e dyta, duhet sqaruar për çfarë gjetjesh bëhet fjalë?
Në lidhje me mikrogjeneratorët:
13. Sa kërkesa të tjera janë në pritje për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues me vetkonsum? Cilat janë procedurat për marrjen e këtij statusi dhe sa zgjatë kjo procedurë?
Në lidhje me Draftin për Vendosjen e PSO-së për Siguri të Furnizimit:
14. Cila është kostoja financiare që do ta paguajnë qytetarët e Kosovës nëse kjo PSO miratohet?
15. Sa palë kanë komentuar në këtë PSO dhe a mund t'i sjellë ZRRE në Kuvend ato qëndrime?
16. Cili ka qenë qëndrimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nëse ka pasur komente) në lidhje me këtë dokument?
17. A u është kthyer përgjigje me shkrim dhe a janë marrë parasysh komentet e të gjitha palëve?
Në lidhje me ndryshimet në shqyrtimin e dytë periodik 2017 – 2022

18. Cilat janë ndryshimet kryesore në dokumentet për këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake të shqyrëtimit.
19. Cili është numri i komenteve që ka marrë ZRRE dhe sa prej tyre janë marrë parasysh e sa jo dhe se a u është ofruar përgjigje me shkrim palëve që kanë komentuar?
20. Sa vendime gjatë vitit 2018 janë ndryshuar apo modifikuar si rezultat i konsultimeve publike? A ekzistojnë raporte të konsultimit me palët ku sqarohen të gjitha komentet dhe shqyrtohen me objektivitet?
21. Përse buxheti për meditime është më shumë se dyfish më i lartë sesa buxheti për udhëtime jashtë vendit?
22. Si ka ndikuar mosrealizimi i 2/3 të buxhetit për investime në kryerjen e mandatit dhe misionit të ZRRE-së. Cilat investime kanë mbetur të pa realizuara dhe cilat janë pasojat në interesin publik dhe performancën e ZRRE-së?
Në lidhje me masat e ndërmarra në lidhje me reduktimet:
23. Cilat masa janë marrë për të ndalur reduktimet. A janë ndëshkuar kompanitë përgjegjëse dhe cili ka qenë efekti?